



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 janar 2013
Nr. ref.:RK376/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI113/12

Parashtrues

Haki Gjocaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, P. nr. 791/2012, të 5 tetorit 2012, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 175/12, të 6 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Haki Gjocaj, i përfaqësuar nga Hilmi Zhitija, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, P. nr. 791/2012, të 5 tetorit 2012, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 175/12, të 6 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit për t'u liruar nga pavijoni psikiatrik i institucionit korrektues dhe për t'u vendosur në një institucion civil shëndetësor.
4. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, propozon vendosjen e masës së përkohshme për lirim të tij nga pavijoni psikiatrik i institucionit korrektues dhe vendosjen e tij në një institucion civil shëndetësor, ku ai mund të shërohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shëndetësinë, siç përcaktohet me nenin 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 34/2004.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 dhe në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 dhjetor 2012, parashtruesi i bashkëngjiti kërkesës dokumente shtesë.
8. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese, si dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
9. Më 28 dhjetor 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 18 dhe 25 janar 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç provohen me dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës

11. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik në Pejë paraqiti Aktakuzën PP. nr. 283/10 ndaj parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Qarkut në Pejë, me ç'rast propozoi shqiptimin e trajtimit të obligueshëm psikiatrik në një institucion shëndetësor, në bazë të dyshimit për kryerjen e veprës penale – vrasje, nga neni 147, pika 4, në lidhje me nenin 24, dhe për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK)
12. Më 21 nëntor 2011, Prokurori, para fillimit të gjykimit, ndryshoi aktakuzën ndaj parashtruesit të kërkesës, duke e akuzuar atë për veprën penale – vrasje, nga neni 147, pika 4, në lidhje me nenin 24, dhe për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas KPPK-së, me ç'rast propozoi që parashtruesi i kërkesës të shpallet fajtor dhe të dënohet në pajtim me ligjin.

Pretendohet se ndryshimi i aktakuzës u bë pas kryerjes së ekspertizës psikiatrike në Spitalin rajonal në Pejë, më 14 tetor 2011.

13. Më 9 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Vendimin P. nr. 137/11, duke pushuar procedurën penale.

14. Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi:

"Se i akuzuari Haki Gjocaj nuk ka aftësi për t'iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në lëndën penale nr. 137/11".

"Konform nenit 9, paragrafi 1 të Rregullores 34/2004, të datës 24.08.2004, mbi procedurën penale, ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, për shkak të paafhtësisë së të akuzuarit për t'iu nënshtruar gjykimit, si dhe për shkak të sëmundjes së tij të përhershme, PUSHOHET PROCEDURA PENALE ndaj të akuzuarit Haki Gjocaj".

"Procedura ndaj të njëjtit rifillon me kërkesën e paditësit të autorizuar, për sa të pushojnë së ekzistuari arsyet për marrjen e aktvendimit të tij".

15. Gjykata e Qarkut në Pejë, në Aktvendimin e saj P. nr. 137/11, më tutje, arsyeton:

"Prokurori Publik i Qarkut në Pejë, në këtë gjykatë, ka ngritur aktakuzën PP. nr. 283/10 të datës 16.02.2011, kundër të akuzuarve F. D., për shkak të veprës penale: Shtytje në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147, pika 4 e lidhur me nenin 24 të KPK-së, F. D. dhe F. Gj., për shkak se si bashkë-kryes kanë kryer vepër penale: Vrasje në tentative nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe kundër të akuzuarit Haki Gjocaj për shkak të veprave penale: Vrasje e rëndë nga neni 147 pika 4 të KPK-së dhe vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par 2 të KPK-së".

"Me urdhër të kësaj gjykate PPQ nr. 86/10, të datës 11.10.2011, në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, pika a dhe b, të Rregullores së UNMIK-ut 2004/34, të datës 24.08.2004, e që ka të bëjë me procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, është urdhëruar që në QKUK, në Klinikën e Psikiatrisë, Reparti i Forenzikës, të bëhet ekzaminimi dhe observimi psikiatrik klinik i të akuzuarit Haki Gjocaj".

16. Pas propozimit të Prokurorit të Qarkut në Pejë, më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Vendimin P. nr. 297/12, ia vazhdoi paraburgimin parashtruesit të kërkesës në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues.

17. Gjykata e Qarkut në Pejë, në aktvendimin e saj P. nr. 297/12, arsyeton më tutje:

"Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktvendimin P. nr. 297/2012 datës 28.09.2012, të akuzuarit Haki Gjocaj, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 pika 4 të të KPK si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, konform nenit 286 par. 3 lidhur me nenin 7 par. 7.1 pika a, b, c, par. 7.2, 7.3, 7.4, 7.5 dhe 7.6 të Rregullores nr. 34/2004 të datës 24.08.2004 Mbi procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, i është vazhduar paraburgimi të akuzuarit Haki Gjocaj edhe për 2 (dy) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do të zgjasë deri me datën 28.11.2012 e me qenë se i akuzuari aktualisht ndodhet në gjendje me çrregullime mendore, është urdhëruar që paraburgimi të mbahet në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor".

Ligji

Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 34/2004 (Vendimi i Gjykatës së Qarkut P. nr. 297/12, të datës 28 shtator 2012)

“Neni 7

Paraburgimi i personave me çrregullime mendore

7.1 Përveç rasteve sipas nenit 281 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, ku paraburgimi mund të urdhërohet, gjykata mund të urdhërojë paraburgimin e një personi, nëse:

(a) Ekziston dyshimi i bazuar që ai person ka kryer vepër penale;

(b) Sipas një kontrolli psikiatrik të urdhëruar sipas nenit 6.1, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore apo kapacitetit të zvogëluar mendor në kohën e kryerjes së veprës penale; si dhe

(c) Personi aktualisht ka çrregullim mendor dhe si rezultat i kësaj, ka baza për të dyshuar që ai/ajo mund të rrezikojë jetën apo shëndetin e një personi tjetër.

7.2 Paraburgimi në bazë të paragrafit 1 të këtij neni mund të urdhërohet vetëm nëse prokurori publik ka parashtruar kërkesë, sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje. Ky paraburgim do të mbahet në një institucion shëndetësor, si dhe mund të zgjasë për aq gjatë derisa i pandehuri është i rrezikshëm, por nuk mund të kalojë periudhat e përshkruara kohore për paraburgim të përcaktuara me nenin 284 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

7.3 Nëse i pandehuri është tanimë në paraburgim, si dhe më vonë përcaktohet të ketë qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron paraburgimin e të pandehurit në një institucion shëndetësor, nëse ai apo ajo aktualisht ka çrregullime mendore.

7.4 Gjykata nxjerr vendimin në bazë të paragrafit 1 ose 3 të këtij neni vetëm pas dëgjimit të prokurorit publik, avokatit mbrojtës dhe të pandehurit, nëse gjendja e tij apo e saj e mundëson këtë, si dhe pas marrjes së mendimit të një eksperti. Vendimi i tillë i lëshohet prokurorit publik, të pandehurit dhe avokatit të tij/saj mbrojtës, institucionit shëndetësor dhe institucionit korrektues. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit.

7.5 Institucioni shëndetësor vendos mbi masat për sigurimin e rendit publik dhe sigurisë e mbrojtjes së të pandehurit pas konsultimit me autoritetin kompetent të mbajtjes, duke marrë parasysh nevojat e sigurisë dhe ato terapeutike.

7.6 Dispozitat e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale për paraburgim zbatohen mutatis mutandis për paraburgimin e vuajtur në institucion shëndetësor.

Dispozitat e përmendura të Rregullores së UNMIK-ut 34/2004 (Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 137/11, të datës 9 korrik 2012), Neni 9 Ndërprerja apo pezullimi i procedurës për shkak të vendimit për paaftësi të paraqitjes në gjykim.

9.1 Nëse gjykata vendos që i pandehuri është i paaftë të paraqitet në gjykim gjatë procedurës, për shkak të çrregullimit të përhershëm mendor, gjykata nxjerr vendimin për ndërprerje të procedurës.

9.4 Nëse gjykata vendos që i pandehuri është i paaftë të paraqitet në gjykim, sipas këtij neni, ajo mund të kërkojë iniciimin e procedurës për vendosjen e tij apo saj në një institucion shëndetësor, në bazë të Ligjit të zbatueshëm për Procedurën Jokontestimore.

Në këtë rast, gjykata mund të vendosë që i pandehuri të mbahet në një institucion shëndetësor për një periudhë maksimale prej 72 orësh, deri në iniciimin e procedurës për mbajtje në institucion shëndetësor sipas Ligjit të zbatueshëm për Procedurën Jokontestimore, nëse si rezultat i çrregullimit mendor të personit, ka baza për të besuar që ai apo ajo do të rrezikojë jetën apo shëndetin e një personi tjetër”.

18. Parashtruesi u ankua ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut, si dhe, më 5 tetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Vendimin P. nr. 791/2012, duke vendosur që:

“Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Haki Gjocaj, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, P. nr. 297/2012, datë 28.09.2012”.

19. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe, më 6 nëntor 2012, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj Pkl. nr. 175/12, miratoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit, duke vendosur si në vijim:

“Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtjes së të pandehurit Haki Gjocaj, anulohet vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P. nr. 297/2012, i datës 28.09.2012, si dhe vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, Pn. nr. 791/2012, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim”.

“I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e vendimit të ri”.

20. Gjykata Supreme më tej arsyetoi:

“Prokurori publik ka paraqitur këtë propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, edhe pse eksperti kishte deklaruar se i pandehuri Haki Gjocaj në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i llogaritshëm por me aftësi të zvogëluar mendore. Pas vërejtjeve të Gjykatës Supreme se ndaj personit të përgjegjshëm nuk mund të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, prokurori publik ndërron aktin akuzues nga propozimi në aktakuzë dhe ndaj të pandehurit Haki Gjocaj vijon procedurën sipas dispozitave të KPPK, deri në momentin kur mjeku psikiatër është deklaruar se i pandehuri nuk është në gjendje të përcjell gjykimin. Më pastaj, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë me datën 09.07.2012. ka marrë aktvendim me numër P. nr. 137/2011 me të cilin ka vendosur që të pushohet procedura ndaj të pandehurit Haki Gjocaj, konform nenit 7. të Rregullores nr. 2004/34 mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore, e cila do të rifilloje posa pushojnë së ekzistuari arsyet për marrjen e vendimit të këtillë”.

“... për të dalë nga kjo situatë gjykata e shkallës së parë duhet të urdhërojë një observim psikiatrik ndaj të pandehurit me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë ose jo përgjegjësisë së tij në kohën e kryerjes së veprës penale dhe gjendjen e

tanishme të tij për t'u qartësuar së cila procedurë duhet të aplikohet - procedura e rregullt apo procedurë e posaçme sipas Rregullores së 2004/34. Duhet theksuar se për tani i pandehuri po trajtohet si person me paaftësi mendore pa një mendim të ekspertit kompetent nga se konstatimi se i pandehuri nuk është në gjendje ta përcjell gjykimin nuk e ka zgjidhe çështjen se ai ishte i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe nuk është përgjigje së kjo paaftësi është e përkohshme apo e përhershme”.

21. Raportet mjekësore përmenden vetëm në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka bashkëngjitur ato në kërkesë. Përmenden disa raporte mjekësore kundërthënëse për gjendjen mjekësore të parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka shkelje të nenit 29 [E drejta e Lirisë dhe e Sigurisë]; të nenit 31, paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 51, paragrafi 2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]; dhe të nenit 55 [Kufizimi i Lirive dhe të Drejtave Themelore], të Kushtetutës.
23. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, konsideron se ka shkelje të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të Protokolleve të saj.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkeljet e sipërpërmendura kanë ndodhur për shkak se ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë për pushimin e procedurës penale për shkak të sëmundjes së përhershme mendore dhe, prapëseprapë, ai gjendet në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues.
25. Parashtruesi i kërkesës pohon se, në bazë të nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, në rastet kur pushohet procedura penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të ketë ndjekje penale. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, pohon se janë shkelur edhe disa nene të tjera të KPPK-së nga ana e gjykatave të rregullta.
26. Parashtruesi i kërkesës mëton se gjykatat e rregullta është dashur të zbatonin nenin 9.4 të Rregullores 34/2004, që parashikon se gjykata inicion procedurën për të dërguar një person me çrregullime mendore në institucion shëndetësor në bazë të dispozitave të procedurës jokontestimore, në mënyrë që ai të trajtohet në pajtim me Ligjin për Shëndetësi. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, pretendon se gjendet në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues që nga 23 gushti 2010 dhe se shëndeti i tij mendor vetëm se do të përqeshohet përdërisa është atje.
27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës që të konstatoj shkeljet e lartpërmendura të dispozitave të Kushtetutës, si dhe të anulojë vendimin e shkallës së parë, P. nr. 297/12, të 28 shtatorit 2012, të anulojë vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pn. nr. 791, të 5 tetorit 2012, si dhe të lirohet nga paraburgimi, ashtu që Gjykata të inicojë procedurë jokontestimore për ta vendosur në institucion shëndetësor, ashtu siç përcaktohet me nenin 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 34/2004.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

28. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pkl. nr. 175/12, i 6 nëntorit 2012), pas kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, urdhëroi që gjykatat e shkallëve më të ulëta të veprojnë në pajtim me udhëzimet e Gjykatës Supreme, si dhe të përcaktojnë se cila nga KPPK-ja apo Rregullorja e UNMIK-ut 34/2004 janë të zbatueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.
31. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka konstatuar se ka ekzistuar një situatë e paqartësisë ligjore dhe e ktheu rastin në gjykatat më të ulëta për rivendosje, me ç'rast, po ashtu, vendosi që parashtruesi i kërkesës të mbetej në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues deri sa të nxirrej një vendim për këtë çështje.
32. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, sepse Gjykata Supreme ka kthyer rastin për rivendosje, që do të thotë se rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt gjyqësore.
33. Përveç kësaj, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e Kosovës, si dhe gjykatat e tjera të rregullta, janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe se është obligim dhe prerogativë e tyre kushtetuese që të interpretojnë çështjet e faktit dhe të ligjit përkitazi me rastet e ngritura para tyre.
34. Arsytimi për rregullin e shterimit është që autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, t'u ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999*).
35. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi *prima facie* dhe as që ka mbështetur me prova kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se si dhe përse vendosja e masës së përkohshme do të parandalonte një situatë të dëmit të pariparueshëm dhe në asnjë mënyrë nuk ka treguar se një gjë e tillë është në interesin publik.
36. Duke marrë parasysh të gjitha që u thanë më lart, Gjykata hedh poshtë kërkesën e parashtruesit për vendosje të masës së përkohshme.
37. Rrjedhimisht kërkesa nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenet 27 e 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 dhe me nenin 27 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 25 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani